

VENDIM
Nr.495, datë 17.7.2006

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “RADIO
BBC”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21, dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të nenit 113 pika c të Kodit të Procedurave Administrative të RSH, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.003/PPH, të rinovojë për një afat të ri 4-vjeçar për ritransmetimin e programeve të huaja, radion me përsëritës “BBC”.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 11.9.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj